



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË

VENDIM

Nr. 06 DATE 31/01/2024



**“MIRATIMIN E LISTËS SË PARCELAVE KULLOSORE VERORE/DIMËRORE QË
DO TË KONTRAKTOHEN PËR PËRDORIMIN ME QIRA PËR KULLOTJE PËR
SEZONIN VEROR 2024 DHE SEZONIN DIMËROR 2024-2025 ”**

Në mbështetje të ligjit 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, në Nenin 26 të Ligjit Nr.49/2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 9693, datë 19.03.2007 “Për fondin kullësor” (të ndryshuar), si dhe në Nenin 2 të Udhëzimit Nr. 2, datë 27.07.2016 “Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje dhe kositje bari” të Ministrisë së mjedisit, Këshilli i Bashkisë Gjirokastrë në mbledhjen e datës 31/01/2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë.

VENDOSI:

1. Të miratojë parcelat kullësore verore dhe dimërore sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë, Pyjeve, Ujitjes dhe Kullimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETAR I KËSHILLIT

Etleva Yzo

KRYETAR I KËSHILLIT

Merita Isaraj

